



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

ARSIMI PROFESIONAL I



Prishtinë, 23 qershor 2012

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t’u përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t’i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t’u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t’ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t’u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

KIMI

1. Me cilën metodë mund të ndahet përzierja e lëngjeve që kanë pika të ndryshme të vlimit ?

- A. Me ndarje me magnet
- B. Me distilim fraksional
- C. Me filtrim
- D. Me sublimim

2. Sa është pH e një tretësire acidike ?

- A. pH=3
- B. pH=7
- C. pH=11
- D. pH=14

3. Cilat grimca subatomike gjenden në bërthamën e atomit ?

- A. Vetëm elektronet
- B. Vetëm neutronet
- C. Protonet dhe neutronet
- D. Protonet dhe elektronet


4. Si quhet reaksioni i bashkëveprimit të acideve karboksilike me alkoole ?

- A. Elektrolizë
- B. Hidrolizë
- C. Polimerizim
- D. Esterifikim

5. Cili nga komponimet vijuese, kur reagon me ujë liron hidrogjenin e gaztë ?


- A. LiH
- B. CH₄
- C. NH₃
- D. H₂S

6. Në këtë reaksion kimik, njëri nga produktet e fituara është:






- A. etil benzeni
- B. klor benzeni
- C. metil fenil ketoni
- D. metil benzeni

7. Cilat nga çiftet vijuese janë izomerë në mes vete ?



B.



8. Çfarë mjedisi tregon tretësira ujore e karbonatit të natriumit (Na_2CO_3) ?

- A. Bazik
- B. Acidik
- C. Neutral
- D. Amfotern





9. Cili është dallimi në mes të jonit të natriumit (Na^+) dhe atomit të natriumit (Na) ?

- A. Joni i natriumit (Na^+) ka një proton më pak sesa atomi i natriumit (Na)
- B. Joni i natriumit (Na^+) ka një elektron më pak sesa atomi i natriumit (Na)
- C. Joni i natriumit (Na^+) ka një proton më shumë sesa atomi i natriumit (Na)
- D. Joni i natriumit (Na^+) ka një elektron më shumë sesa atomi i natriumit (Na)

10. Cili reaksion ndodh gjatë elektrolizës së klorurit të magnezit MgCl_2 të shkrirë ?

- A. $\text{Mg}^{+2} \rightarrow \text{Mg} + 2\text{e}^-$
- B. $\text{Mg} \rightarrow \text{Mg}^{+2} + 2\text{e}^-$
- C. $\text{Mg}^{+2} + 2\text{e}^- \rightarrow \text{Mg}$
- D. $\text{Mg} + 2\text{e}^- \rightarrow \text{Mg}^{+2}$

11. Cili komponim përfitohet me oksidimin e propanolit-1 ?



12. Cilat sheqerna bëjnë pjesë në grupin e monosakarideve ?

- A. Laktoza dhe riboza
- B. Maltoza dhe amidoni
- C. Fruktoza dhe glukozë
- D. Saharoza dhe celuloza

13. Në një epruvetë janë përzier kristalet e klorurit të natriumit (NaCl) dhe të klorurit të amonit (NH₄Cl), nëse epruveta nxehtet në flakëdhënës do të vërejmë se:

- A. të dy kripërat shkrihen
- B. të dy kripërat sublimojnë
- C. NH₄Cl mbetet në pjesën e nxehtë ndërsa NaCl sublimon në pjesën e ftohtë të epruvetës
- D. NaCl mbetet në pjesën e nxehtë ndërsa NH₄Cl sublimon në pjesën e ftohtë të epruvetës


14. Një kimist i teston analizon dy substanca kristalore me ngjyrë të bardhë, A dhe B. Rezultatet e analizës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Lloji i analizës	Substanca A	Substanca B
Pika e shkrirjes	801°C	E ulët, zbërthehet në 186°C
Tretshmëria (g) për 100g H ₂ O	35.7 g	3.2 g
Përçueshmëria elektrike (në tretësira ujore)	Përçues i mirë	Jopërçues


Nga rezultatet e këtyre testeve përfundojmë se:

- A. të dy substancat A dhe B kanë lidhje jonike
- B. të dy substancat A dhe B kanë lidhje kovalente
- C. substanca A ka vetëm lidhje jonike ndërsa substanca B vetëm lidhje kovalente
- D. substanca A ka vetëm lidhje kovalente ndërsa substanca B vetëm lidhje jonike


15. Cili nga hidrokarburet vijuese ka pikën e vlimit më të lartë ?




B.



C.



D.



16. Cilat janë simbolet kimike të hekurit, karbonit dhe bakrit ?

- A. He, K, Ba
- B. Fe, Ca, Cu
- C. Fe, C, Cu
- D. He, K, Br

17. Cilat nga këto okside kanë veti acidike ?

- A. CaO, CO₂, CO
- B. SO₃, N₂O₅, P₄O₁₀
- C. CaO, Na₂O, MgO
- D. MgO, ZnO, SO₂


18. Prej cilave metale përbëhet aliazhi i tunxhit ?

- A. Cu dhe Zn
- B. Cu dhe Sn
- C. Fe dhe Ni
- D. Fe dhe Mn

19. Çfarë ngjyre ka metiloranzhi në mjedis bazik ?

- A. Të gjelbër
- B. Të verdhë
- C. Të kaltër në të gjelbër
- D. Të kuqe në të vjollce

20. Çfarë orbitale hibride ka atomi qëndror i karbonit në komponimin vijues ?



- A. sp³
- B. sp²
- C. sp³d
- D. sp

21. Sa është përqendrimi në mol/dm³ i tretësirës së dhënë në figurë?
M (NaCl) = 58.45 g mol⁻¹




- A. 0.154 mol/dm³
- B. 0.015 mol/dm³
- C. 0.03 mol/dm³
- D. 0.09 mol/dm³

22. Cila vitaminë është e tretshme në ujë ?

- A. Vitamina E
- B. Riboflavina
- C. Retinoli
- D. Vitamina D

23. Lëngu i lukthit përfaqësohet ka pH=2, ndërsa qumështi ka pH=6.



Përqendrimi i joneve H⁺ (aciditeti) në lukth:

- A. është 3 herë më i madh se në qumësht
- B. është 4 herë më i madh se në qumësht
- C. është 10000 herë më i madh se në qumësht
- D. është 1000 herë më i madh se në qumësht

24. Duke u bazuar në tabelën e dhënë konstatojmë se: ngritja e pikës së vlimit të elementeve halogjene prej F₂ deri tek I₂ vjen si rezultat i:

- A. lidhjes jonike
- B. fortësisë së lidhjes kovalente
- C. afinitetit elektronik
- D. forcave të Van der Walsit

Elementi kimik	Pika e vlimit/°C
F ₂	-188
Cl ₂	-34.0
Br ₂	+58.8
I ₂	+184.5

25. Cili nga halogjenalkanet vijuese përdoret në mjekësi si anestetik modern ?

- A. Tetraklormetani
- B. Enflurani
- C. Lindani
- D. Freoni

BIOLOGJI

26. Cili nga këto gjene është heterozigot ?

- A. AaBb
- B. aabb
- C. AABB
- D. AACC

27. Sa palë çifte nervore dalin prej trurit të shpendëve ?

- A. 10 palë
- B. 12 palë
- C. 20 palë
- D. 24 palë

28. Cila nga këto bimë përmban më së shumti fitoncide ?

- A. Molla
- B. Dardha
- C. Kumbulla
- D. Eukaliptusi

29. Cili organ i tretjes te njeriu e pengon kalimin e ushqimit në rrugët e frymëmarrjes ?

- A. Faringu
- B. Laringu
- C. Epiglotisi
- D. Duodenumi

30. Në cilën pjesë të qelizës kryhet oksidimi i materieve organike përmes ciklit të Krebsit ?

- A. Mitokondrie
- B. Ribozome
- C. Citoplazmë
- D. Kloroplaste

31. Nëse te prindërit gjenotipi për përcaktimin e grupeve të gjakut është BB x A0, çfarë do të jetë gjenotipi te pasardhësit ?

- A. AO, AB
- B. AB, OO
- C. AB, BO
- D. OA, OB

32. Çka ndodh në organizmin e njeriut nëse nuk funksionojnë veshkat ?

- A. Ndërprerja e filtrimit të gjakut
- B. Ndërprerja e qarkullimit të gjakut
- C. Ndërprerja e prodhimit të insulinës
- D. Ndërprerja e prodhimit të tiroksinës

- 33.** Cilat organele qelizore e kryejnë zbërthimin e materieve organike në qelizë ?
- A. Aparati i Golxhit
 - B. Kloroplastet
 - C. Lizozomet
 - D. Centrozomet
- 34.** Cila prej bimëve të mëposhtme është indikator biologjik që përcakton shkallën e ndotjes së mjedisit ?
- A. Pisha
 - B. Myshqet
 - C. Gështenja
 - D. Fieri
- 35.** Cila metodë aplikohet për pastrimin e mjedisit të ndotur nga bakteriet duke i përdorur acidet ?
- A. Sterilizimi
 - B. Deratizimi
 - C. Pasterizimi
 - D. Dezinfektimi
- 36.** Cila është faza e parë e ciklit të zhvillimit të bakteriofagut ?
- A. Ngjitja e virusit për sipërfaqen e qelizës bakteriale
 - B. Depërtimi i acidit nukleik të virusit në qelizën bakteriale
 - C. Formimi i kapsidave dhe acideve nukleike të viruseve
 - D. Kompletimi dhe lirimi i bakteriofagëve të rinj
- 37.** Gjatë procesit të frymëmarrjes oksigjeni (O_2) kalon direkt nga ajri në gjak përmes:
- A. trakeve
 - B. faringut
 - C. laringut
 - D. alveoleve
- 38.** Cilat etapa të njëpasnjëshme kryhen në interfazë gjatë një cikli të ndarjes qelizore ?
- A. G_1 -S- G_2
 - B. G_1 - G_2 -S
 - C. S- G_2 - G_1
 - D. G_1 - G_2 -S

39. Qarkullimi i madh i gjakut te njeriu:

- A. fillon nga barkushja e djathtë dhe përfundon në veshëzën e djathtë
- B. fillon nga veshëza e djathtë dhe përfundon në barkushen e majtë
- C. fillon nga barkushja e majtë dhe përfundon në veshëzën e djathtë
- D. fillon nga veshëza e majtë dhe përfundon në barkushen e djathtë

40. Sa aminoacide gjatë sintezës së proteinave kodohen nga vargu i mëposhtëm i ARN(i) ?
CGUUUACACCGUCAC

- A. Tri aminoacide
- B. Pesë aminoacide
- C. Gjashtë aminoacide
- D. Tetë aminoacide

41. Cila nga këto pjesë përbërëse të qelizës është karakteristike vetëm për qelizat bimore ?

- A. Muri qelizor
- B. Bërthama
- C. Ribozomi
- D. Mitokondria

42. Cili hormon te njeriu e rritë përqendrimin e sheqerit në gjak ?

- A. Insulina
- B. Glukagoni
- C. Tiroksina
- D. Estrogjeni

43. Në cilën familje të dythelboreve bënë pjesë molla ?

- A. Fluturore
- B. Ahore
- C. Trëndafilore
- D. Kompozite

44. Cili është roli i trikocisteve te papuqëza ?

- A. Për sulm
- B. Për tajitje
- C. Për lëvizje
- D. Për ushqim

45. Si quhet procesi i gëlltitjes së bakteve nga rruazat e bardha të gjakut ?

- A. Pinocitozë
- B. Fagocitozë
- C. Osmozë
- D. Ekzocitozë

46. Cilat organe të tretjes i derdhin lëngjet e tyre në duodenum ?

- A. Laringu dhe lukthi
- B. Lukthi dhe zorra e hollë
- C. Goja dhe lukthi
- D. Pankreasi dhe mëlçia

47. Në cilin grup të eshtrave bënë pjesë tibia ?

- A. Eshtrat e qafës
- B. Eshtrat e kafkës
- C. Eshtrat e kurrizit
- D. Eshtrat e gjymtyrëve

48. Cila nga këto sëmundje është sëmundje e syrit ?

- A. Kariesi
- B. Trakoma
- C. Meningjiti
- D. Difteria

49. Cili hormon nuk do të sintetizohet në organizmin e njeriut nëse nuk funksionon neurohipofiza ?

- A. Tiroksina
- B. Adrenalina
- C. Oksitocina
- D. Melatonina

50. Në cilin organ deponohet glikogjeni te organizmi i njeriut ?

- A. Në mëlçi
- B. Në mushkëri
- C. Në lukth
- D. Në pankreas

INFORMATIKË

- 51.** Ç`është memoria virtuale (Virtual Memory)?
- A. Memorie që plotëson kërkesën për vlerë shtesë të RAM-it
 - B. Memorie për sisteme operative që punojnë në kohë jo reale
 - C. Memorie për sisteme operative të rrjeteve
 - D. Memorie që ruan sasinë minimale të të dhënave
- 52.** Shtypësi mund të kyçet në:
- A. Portin Serik
 - B. Portin USB
 - C. Portin e lojërave
 - D. Në cilin do port
- 53.** Fajllat e tipit grafik kanë prapashtesën (ekstensionin) vijuese:
- A. .bmp, .jpg, .php
 - B. .gif, .rtf, .jpg
 - C. .bmp, .jpg, .gif
 - D. .ppt, .jpg, .php
- 54.** Cila nga konstatimet vijuese është e saktë në lidhje me ROM -BIOS:
- A. Ruan programin për startimin e njësive hyrëse të sistemit kompjuterik
 - B. Ruan programin për startimin e njësive dalëse të sistemit kompjuterik
 - C. Ruan programin për të dhënat e RAM memories
 - D. Ruan programin për startimin e njësive hyrëse-dalëse të sistemit kompjuterik
- 55.** Të përcaktohet renditja e saktë e komponentëve të sistemit kompjuterik , mbështetur në shpejtësinë e transmetimit të të dhënave dhe duke filluar nga më e shpejta:
- A. disketa, RAM, hard disk, CD-ROM,
 - B. RAM, Hard disk, CD_ROM, disketa
 - C. Hard disk, RAM, CD_ROM, disketa
 - D. RAM, hard disk, disketa, CD-ROM
- 56.** Cila nga shprehjet vijuese është e saktë:
- A. 1MB =1024KB
 - B. 1GB < 1024KB
 - C. 1MB = 1024GB
 - D. 1GB > 1024MB

- 57.** Kartela grafike lidh:
- A. Monitorin dhe hard diskun
 - B. Monitorin dhe memorien
 - C. Monitorin dhe tastieren
 - D. Monitorin dhe pllaken qendrore
- 58.** Cila nga formulimet e mëposhtme paraqet një adresë Interneti (IP adresë) :
- A. 145-124-202-34
 - B. 138@234@24@12
 - C. 110.39.213.218
 - D. 112157189219
- 59.** Shkurtesa e protokolit për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet klientit dhe serverit, i cili është përgjegjës për bartjen e të dhënave brenda Web shërbimeve të Internetit, është:
- A. FTP
 - B. TCP/IP
 - C. TELNET
 - D. HTTP
- 60.** Cila pjesë e e-mail adresës travel@tourist.uk e tregon një zonë gjeografike :
- A. uk
 - B. @
 - C. travel
 - D. tourist
- 61.** Cila nga veprimet vijuese mund ta infektoj një kompjuter me viruse:
- A. Dëgjimi i një CD-je muzikore pirate
 - B. Hapja e një attachmenti në e-mail.
 - C. Shikimi i një DVD filmi
 - D. Instalimi i harduerit të ri
- 62.** Bazuar në funksionin e shkruar në celulën F2, pas ekzekutimit do të fitohet vlera:

- A. 5
- B. 15
- C. 25
- D. 35

	A	B	C	D	E	F	G
1							
2	4	6	8	7		=SQRT(SU	
3							

63. Adresat absolute në programin MS Excel, të cilat nuk ndryshojnë të dhënat edhe kur formula që i përmbanë ato kopjohet në pozicione tjera, ka formën:

- A. \$E30
- B. \$(E30)
- C. \$\$E30
- D. E30\$

64. Organizimi i imazheve në PowerPoint bëhet nëpër:

- A. Tabela (ang. Table)
- B. Gr Sllajde (ang. Slide)
- C. afik (ang. Graph)
- D. Foto (Photo)

65. Për krijimin e pjesëve të përbashkëta të një prezantimi, si : header-i, footer-i, data, numri i sllajdit, etj. , shfrytëzohet opsioni:

- A. View/Master/Slide Master
- B. View/Slide Show
- C. View/Task Pane
- D. View/ Slide Sorter

EKONOMI ME NDËRMARRËSI

66. Numri më i madh i bizneseve në Kosovë, sipas formës ligjore të organizimit, janë biznese:

- A. shoqëri aksionare
- B. biznese ortakërie
- C. biznese individuale
- D. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

67. Zgjedhja e lirë e aktivitetit ekonomik është shtyllë e:


- A. ekonomisë së tregut
- B. ekonomisë së centralizuar
- C. ekonomisë së përzier
- D. ekonomisë në tranzicion

68. Kostot oportune janë:

- A. kosto kontabël
- B. kosto alternative
- C. kosto fikse
- D. kosto financiare


69. Nëse nivelet e çmimit janë mbi çmimin ekuilibër si në figurën e dhënë, sasia e ofruar e produkteve e tejkalon sasinë e kërkuar, duke krijuar:

- A. tepicë të produkteve e cila bën presion për rritjen e çmimeve
- B. mungesë të produkteve e cila bën presion për rënien e çmimeve
- C. mungesë të produkteve e cila bën presion për rritjen e çmimeve
- D. tepicë të produkteve e cila bën presion për rënien e çmimeve



70. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë kombinime të ndryshme të çmimit dhe sasisë së ofruar për produktin X. Paraqitni grafikisht të dhënat nga tabela. Lakorja e përfituar është:

- A. lakorja e ofertës
- B. lakorja e kërkesës
- C. lakorja e mundësive të prodhimit
- D. lakorja e indiferencës



71. Nëse çmimi i një produkti rritet nga 3 € në 4€, kurse konsumatori vazhdon të blej 4 njësi si më parë, fuqia blerëse e konsumatorit do të:

- A. rritet për 4€
- B. zvogëlohet për 3€
- A. zvogëlohet për 4€
- B. rritet për 3€

72. Kënaqësia shtesë që konsumatori e përfiton nga konsumimi i produkteve dhe shërbimeve të blera paraqet:

- A. dobinë totale
- B. dobinë marxhinale
- C. tepricën konsumatore
- D. koston totale

73. Në analizën e zgjedhjes konsumatore, për çdo njësi shtesë të konsumit të një të mire:

- A. dobia marginale do të jetë në rënie
- B. dobia marginale do të jetë në rritje
- C. dobia totale do të jetë vazhdimisht në rënie
- D. dobia totale do të jetë vazhdimisht në rritje

- 74.** Sipas formës organizative firmat ndahen në:
- A. të vogla, të mesme dhe të mëdha
 - B. sektorin parësor, dytësor dhe tretësor
 - C. prodhuese dhe shërbyese
 - D. individuale, ortakëri, dhe korporata
- 75.** Cila nga tiparet e mëposhtme i karakterizon firmat individuale?
- A. përgjegjësia e kufizuar
 - B. formohen nga më shumë individë
 - C. lehtësia për të hyrë në biznes
 - D. tërheqin më shumë kapital
- 76.** Një nga tiparet e monopolit është:
- A. një shitës i produkteve në degë
 - B. disa shitës të produkteve në degë
 - C. lehtësia e hyrjes se firmave te reja në degë
 - D. lehtësia relative e hyrjes se firmave te reja në degë
- 77.** Firmat janë çmim-pranuese në kushtet e:
- A. monopolit
 - B. konkurrencës së plotë
 - C. konkurrencës monopolistike
 - D. oligopolit
- 78.** Renta si çmim i tokës, përcaktohet në tregun e :
- A. faktorëve të prodhimit
 - B. produkteve dhe shërbimeve
 - C. punës
 - D. kapitalit
- 79.** Produkti i Brendshëm Bruto (GDP) llogaritet si shumë e:
- A. konsumit, profitit, interesit, dhe neto eksportit
 - B. pagesave transferuese, interesit, dhe rentës
 - C. pagesave transferuese, interesit dhe profitit
 - D. konsumit, investimeve, shpenzimeve qeveritare dhe neto eksportit
- 80.** Periudha e rënies së prodhimit dhe të ardhurave si dhe rritjes së papunësisë që zgjatë së paku 2-3 muaj një pas një ose 6 muaj është:
- A. niveli më i ulët
 - B. ekspansioni
 - C. recesioni
 - D. pika më e lartë